




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA PËRMBARIMORE

SUELA NDRECA

Nr. 398/7 Prot

Tiranë, më 20.12.2023

Nr. 398 Dosje

URDHËR PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Për dijeni: Shoqëria Sima-Com shpk - NIPT L01502020G

Adresa: Njësia Nr.2, Rruga Mihal Grameno, ("Dalip Zavalani"), Nj. Strukturore TR/ 84, Tiranë

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit- Bashkia Tiranë

Drejtoria Juridike

Adresa: Rruga Abdi Toptani, 1001, Tiranë

Unë, Suela Ndreca, Përmbaarues Gjyqësor, në referim të titullit ekzekutiv Vendim për dënim me gjobë Nr. 4637 datë 03.02.2023 të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit – Bashkia Tiranë (palë debitore Shoqëria Sima-Com shpk – detyrimi i gjobës 1,106,072 lekë) për të cilin është lëshuar Urdhëri i ekzekutimit Vendimi Nr. Regj Them. 3465 (31134-05712-80-2023) Datë rregjistrimi 19.07.2023, Datë vendimi 11.09.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 398 kërkesën e kreditorit Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit- Bashkia Tiranë, ndaj debitorit Shoqëria Sima-Com shpk

Në referim të nenit 519 të K.Pr.Civile është marrë Vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit. Përsa më sipër në referim të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi dokumentacionin e aktiveve, kuotat/aksionet e palës debitore si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre, moskryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar, si dhe të mospajisë me asnjë lloj dokumentacioni debitorin **Shoqëria Sima-Com shpk NIPT L01502020G, Administrator Z. Lorenc Marku**, Adresa: Njësia Nr.2, Rruga Mihal Grameno, ("Dalip Zavalani"), Nj. Strukturore TR/ 84, Tiranë.
2. Për informimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorët e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve.

Përmbaaruesi GJYQËSOR

Suela NDRECA

Adresa: Njesia nr.4, Rruga "Besim Fagu" Pll."Shkreli", Kati I, Tirane, Cel: 0692020415, e-mail: suindreca@yahoo.com

